



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
KËSHILLI BASHKIAK

Pukë, më 04.09. 2025

Nr. 1433/2 prot.

VENDIM

Nr. 25, datë 04. 09. 2025

**“PËR
SHTYRJEN E AFATIT TË ZBATIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT TË BASHKISË PUKË
2022–2025 ME NJË VIT SHITESË”**

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, ligji nr. 9131/2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, VKM nr.516, datë 01.07.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr.247 datë 20.03.2015 ‘Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale e kundër korrupsionit për periudhën 2015-2020 dhe miratimin e planit të veprimit 2020-2023 në zbatim të strategjisë ndërsektoriale kundër korrupsionit 2015-2023 e të pasaportës së indikatorëve”, VKB nr.33, datë 03.08.2022 ‘Për Miratimin e Planit të Integritetit të Bashkisë Pukë 2022-2025’, me propozim të kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Pukë, pas shqyrtimit në mbledhjen e datës 04.09.2025;

VENDOSI:

1. Të shtyhet me një vit tjetër afati i zbatimit të Planit të Integritetit të Bashkisë Pukë, nga viti 2025 deri në Gusht 2026.
2. Zgjatja e afatit vjen si nevojë për të mundësuar:
 - Përfundimin e disa masave të papërfunduara në planin aktual;
 - Përforcimin e mekanizmave të parandalimit të korrupsionit dhe rritjen e transparencës institucionale;
 - Përgatitjen e një procesi gjithëpërfshirës dhe cilësor për hartimin e Planit të ri 2026–2030.
3. Për zbatimin e këtij vendimi dhe për ndjekjen dhe raportimin e vazhdueshëm të zbatimit të këtij plani në periudhën e shtyrë, ngarkohen: Sekretari i Përgjithshëm i Bashkisë Pukë dhe Koordinatori i Integritetit.
4. Ky vendim hy në fuqi 10 ditë pas shpalljes, sipas ligjit 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 55, pika 6.

5. Vendimi u shpall me date 04.09.2025.

Vota te vlefshme gjithsej 9

Vota pro 9 , Vota kunder 0 , Vota abstenim 0

SEKRETARI
Hazbi Terbuni

